



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo



Komuna e Istog  
Opština Istok  
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel: 038/200 438 14

---

## KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

---

### P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e 49<sup>-të</sup> e rregullt e Legjislacionit të V<sup>-të</sup> të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: 31.07.2017, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora 10:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

- |                          |                           |
|--------------------------|---------------------------|
| 1. Hazbi Bajra, LDK;     | 13. Shaip Çeta, AAK;      |
| 2. Besa Ferati, LDK;     | 14. Misin Berisha, AAK;   |
| 3. Enver Rugova, LDK;    | 15. Afërdita Blakaj, AAK; |
| 4. Gjevdet Metaj, LDK;   | 16. Arben Kabashi, PDK;   |
| 5. Luljeta Zeqiraj, LDK; | 17. Arnesta Gashi, PDK;   |
| 6. Haki Podrimaj, LDK;   | 18. Mirushe Sadikaj, PDK; |
| 7. Selajdin Bytyçi, LDK; | 19. Florin Dreshaj, VV;   |
| 8. Mahije Sadikaj, LDK;  | 20. Lavdije Bujupaj, VV;  |
| 9. Edona Lubeniqi, LDK;  | 21. Elvira Zeqiraj, AKR;  |
| 10. Riza Dreshaj, LDK;   | 22. Arif Elshani, AE;     |
| 11. Hajrush Shoshi, LDK; | 23. Bahta Sejdović, GIB;  |
| 12. Naim Imeraj, AAK;    | 24. Kosta Belošević, GIS. |

Mbledhja ishte e hapur dhe në mbledhje ishin të pranishëm edhe: Kryetari i Komunës z. Haki Rugova, Drejtorët e Drejtorateve Komunale, përfaqësues të OSBE-së, KFOR-it, përfaqësues të shoqërisë civile, mediave, disa qytetarë etj (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverbali dhe e njëjta gjendet në dosje: "shembulli 1")

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar edhe CD-t e xhirimit gjenden në dosje: "shembulli 2").

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, kryesuesi i kuvendit z. Hazbi Bajra.

**Kryesuesi** – fillimisht i përshëndeti gjithë të pranishmit në këtë mbledhje, Propozon rendin e ditës për këtë mbledhje.

Konstaton së ekziston kuorumi për mbajtjen e mbledhjes, nga 27 anëtar qe ka kuvendi komunal në Istog prezent janë 25 anëtarët. Shpall të hapura punimet e mbledhjes së sotme me këtë rend dite:

## **R e n d   d i t e**

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluar;
3. Shqyrtimi i raportit financiar për tre mujorin e dytë të vitit fiskal 2017.
4. Shqyrtimi i raportit për 6 mujorë të punës së Kryetarit të Komunës,
5. Shqyrtimi i raportit të punës për 6 mujorin e NP “Ambienti”
6. Shpallja në diskutim publik e Projekt- Rregullores për përdorimin e pijeve alkoolike në lokale publike.
7. Shqyrtimi i Raportit dhe analiza e vitit shkollor 2016-2017.
8. Shqyrtimi i raportin të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2016.
9. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt rregullores për tatimin në pronë.
10. Shqyrtimi dhe miratimi i Plotësimi - Vendimit 01Nr.59/2016 i datës 31.05.2016, për dhënën e pronës komunalë në Istog.
11. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim Vendimit për dhënën me qira të qëndresë Rinorë në Osojanë.

Ky është rendi i ditës të cilin e keni pasur edhe më material para se ta hedh në miratim rendin e ditës, pyet anëtarët e kuvendit a ka dikush diçka, ndonjë propozim për plotësim apo ndryshim të këtij rendi të ditës.

Hap Diskutimin: fjalën ja kalon z. Florin Dreshaj

**Florin Dreshaj** – përshëndet gjithë të pranishmit, propozon një pikë për rend dite, pronat e uzurpuara të komunës.

**Kryesuesi** – kryesuesi hidhe në miratim propozimin e z. Florin Dreshaj kush është që kjo pikë të hy në rendë dite

**Për 10 vota,**

**Kundër 12 vota,**

**Konstatojmë që propozimi i Florin Dreshajt nuk miratohet.**

**Hedh në miratim rendin e ditës, kush është për miratim,**

**Për 12 vota**

**Kundër 5 vota,**

**Konstatojë se rendi i ditës miratohet me shumicë votash.**

Kuorumi është për vazhdimin e mbledhjen prezent janë 24 anëtar të KK.

**Shqyrtimi i pikës 1.**

**Kryesuesi** - arsyetimi i mungesave: mungojnë Naim Imeraj, Prekë Prekaj, pa arsyeje.

**Shqyrtimi i pikës 2.**

**Kryesuesi** - po fillojmë me pikën e dytë të rendit të ditës, miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara.

Hedh në votim procesverbalin e mbledhjes së kaluar kush është për miratim:  
**Kuvendi Komunal një zëri miratoj procesverbalet nga mbledhja e kaluar.**  
**Në mbledhje ishin të pranishëm 25 anëtar të Kuvendit Komunal.**

### **Shqyrtimi i pikës 3.**

**Kryesuesi** - po fillojmë me pikën e tretë të rendit të ditës, Shqyrtimi i raportit financiar për tre mujorin e dytë të vitit fiskal 2017, materialin e keni pasur dhe keni mundur ta analizoni.

**Drejtori Hysni Maxharraj** – bënë prezantimin dhe sqarimin e raportit financiar për tre mujorin e dytë të vitit fiskal 2017.

**Kryesuesi** – pasi që diskutime tjera nuk pat kalon në pikën e radhës.  
**Në mbledhje ishin të pranishëm 24 anëtar të Kuvendit Komunal**

### **Shqyrtimi i pikës 4.**

**Kryesuesi** - po fillojmë me pikën e katërt të rendit të ditës, Shqyrtimi i raportit për 6 mujorë të punës së Kryetarit të Komunës, kemi pasur edhe dëgjimin publik për këtë raport.

**Kryetari i Komunës** – Përsëndet gjithë të pranishmit, bënë prezantimin dhe sqarimin e raportit për 6 mujorë të punës së Kryetarit të Komunës.

**Kryesuesi** – pasi që diskutime tjera nuk pat kalon në pikën e radhës.  
**Në mbledhje ishin të pranishëm 24 anëtar të Kuvendit Komunal**

### **Shqyrtimi i pikës 5.**

**Kryesuesi** - po fillojmë me pikën e pestë të rendit të ditës, Shqyrtimi i raportit të punës për 6 mujorin e NP “Ambienti”, materialin e keni pasur dhe keni mundur ta analizoni.

**Bedri Hasanaj** ( Drejtor) – përsëndet gjithë të pranishmit, bënë prezantimin dhe sqarimin e raportit të punës për 6 mujorin e NP “Ambienti”.

**Kryesuesi** – pasi që diskutime tjera nuk pat kalon në pikën e radhës.  
**Në mbledhje ishin të pranishëm 24 anëtar të Kuvendit Komunal**

### **Shqyrtimi i pikës 6.**

**Kryesuesi** - po fillojmë me pikën e gjashtë të rendit të ditës, Shpallja në diskutim publik e Projekt- Rregullores për përdorimin e pijeve alkoolike në lokale afariste, bënë prezantimin dhe sqarimin e kësaj rregulloreje.

**Pasi që diskutime nuk pat kalon në pikën e radhës.**

**Në mbledhje ishin të pranishëm 24 anëtar të Kuvendit Komunal**

### **Shqyrtimi i pikës 7.**

**Kryesuesi** - po fillojmë me pikën e shtatë të rendit të ditës, Shqyrtimi i Raportit dhe analiza e vitit shkollor 2016-2017, materialin e keni pasur dhe keni mundur ta analizoni.

**Agim Haxhiaj** ( Drejtor) – Përshëndet gjithë të pranishmit, bënë prezantimin dhe sqarimin e Raportit dhe analiza e vitit shkollor 2016-2017.

**Kryesuesi – pasi që diskutime tjera nuk pat kalon në pikën e radhës.**

**Në mbledhje ishin të pranishëm 24 anëtar të Kuvendit Komunal**

### **Shqyrtimi i pikës 8.**

**Kryesuesi** - po fillojmë me pikën e tetë të rendit të ditës Shqyrtimi i raportin të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2016, materialin e keni pasur dhe keni mundur ta analizoni.

**Kryetari i Komunës** - bënë prezantimin dhe sqarimin e raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2016 dhe planin e veprimit për eliminimit e të gjeturave nga raporti i Auditorit të përgjithshëm.

**Kryesuesi – hedh në miratim planin e veprimit për eliminimin e të gjeturave nga Raporti i Auditori të përgjithshëm.**

**Miratohet një zëri nga anëtarët e Kuvendit komunal.**

**Në mbledhje ishin të pranishëm 24 anëtar të Kuvendit Komunal.**

### **Shqyrtimi i pikës 9.**

**Kryesuesi** - po fillojmë me pikën e nëntë të rendit të ditës Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt rregullores për tatimin në pronë, materialin e keni pasur dhe keni mundur ta analizoni, bënë prezantimin dhe sqarimin e kësaj rregulloreje.

**Hedh në miratim Projekt Rregulloren për tatimin në pronë.**

**Miratohet një zëri nga anëtarët e Kuvendit komunal.**

**Në mbledhje ishin të pranishëm 24 anëtar të Kuvendit Komunal.**

### **Shqyrtimi i pikës 10.**

**Kryesuesi** - po fillojmë me pikën e dhjetë të rendit të ditës Shqyrtimi dhe miratimi i Plotësimi - Vendimit 01Nr.59/2016 i datës 31.05.2016, për dhënën e pronës komunale në Istog, materialin e keni pasur dhe keni mundur ta analizoni, bënë prezantimin dhe sqarimin e Plotësim -Vendimit.

**Hedh në miratim Plotësimi - Vendimit 01Nr.59/2016 i datës 31.05.2016, për dhënën e pronës komunale në Istog.**

**Miratohet një zëri nga anëtarët e Kuvendit komunal.**

**Në mbledhje ishin të pranishëm 20 anëtar të Kuvendit Komunal.**

### **Shqyrtimi i pikës 11.**

**Kryesuesi** - po fillojmë me pikën e dhjetë të rendit të ditës Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim Vendimit për dhënën me qira të qëndresë Rinorë në Osojanë materialin e keni pasur dhe keni mundur ta analizoni, bënë prezantimin dhe sqarimin e Plotësim -Vendimit.

**Hedh në miratim Propozim Vendimit për dhënën me qira të qëndresë Rinorë në Osojanë.**

**Miratohet një zëri nga anëtarët e Kuvendit komunal.**

**Në mbledhje ishin të pranishëm 20 anëtar të Kuvendit Komunal.**

**Kryesuesi** – shpalli të mbyllur mbledhjen e Kuvendit të Komunës.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 13:10.

**Procesmbajtëse,  
Vjosa Hysenaj**

**Kryesues,  
Hazbi Bajra**